



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

Nr. 01-031-254050

Datë 11 OCT 2016 2016

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 25 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, nr. 03/L-164, dt. 25.02.2010, nenit 5, pika 1 e Udhëzimit administrativ nr. 22/2010, për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, dhe të nenit 52, pika c dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

I. Miratohet Vendimi për caktimin e komisionit për ndarjen e banesave për familjet e dëshmorëve, veteranëve, invalidët e luftës dhe nevojat e shpronësimeve, ndërtuar në parcelën kadastrale nr. 584-3, Zona kadastrale Çagllavicë, në pronësi të Komunës së Prishtinës, me sipërfaqe prej 6869 m².

II. Anëtarët e komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Fitore Pacolli, kryetare e komisionit,
2. Valbona Makiqi, anëtare,
3. Munavere Qerkezi, anëtare,
4. Osman Bllaca, anëtar,
5. Ibrahim Morina, anëtar.

III. Detyra e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është të bëjë vlerësimin me pikë sipas kriterëve të përcaktuara në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 21/2010, dt. 18.11.2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.

IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetari i Komunës.

V. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet :

- Anëtarëve të komisionit dhe
- Qendrës për shërbime me qytetarë



KRYETARI I KOMUNËS
SË PRISHTINËS
Sagend Ahmeti